



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr : 04-353/01-74084

Datë: 27.09.2024

Prizren

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike - DSHP me seli në Prizren, e në bazë të nenit 3.alinea 1 pikat 1.1, 1.2, 1.4,1.14, 1.17, 1.20,1.24, e në lidhje me nenin 5 paragrafi1,pika 1.1,1.3 dhe 1.6, si dhe neni 19 alenia 2 të Ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 si dhe në bazë të nenit 129 të vendimit komunal për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve Komunale nr. 01/011-2 dt.18.11.2004 si dhe të nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 dhe 127 LPA-së nr. 05/L-031, si dhe konform nenit 25.1 paragrafi 25. 1.1 të rregullores 02/2022 për Taksat Komunale nr.001/001-99275 dt.30.08.2022 dhe conform Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e parë e mbrojtjes nr.01/011-6604 të dt.18.12.2008 , lëshon këtë:

### AKTVENDIM

- I. **Aprovohet** kërkesa Nr. 04-353/01-74084 e datës 10.06.2024 e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për Realizimin e punimeve në projektin :  
Vendosja e ormanëve elektrike dhe të kablllovikut në “Sheshin Shadërvan ” në zonën e parë të mbrojtur .
- II. Kërkesa e aprovuar sipas pikes I të dispozitivit të këtij Aktvendimi është si në vijim:

Lejohen gjithsej 5 lokacione të ndryshme të “Sheshi Shadërvan” dhe të “Qendrës Historike të Prizrenit:

1. Vendosja e 3(tre)ormaneve elektrike me dimensione 80x35x120cm dhe 1(një) orman me 12-16 njehsor me dimensione 25x20cm,në murin e Kejit pran urës Arasta dhe përball Xhamisë së Sinan Pashës,në lokacionin e paraqitur sipas paraqitjes grafike në situacion të projektit ideor;
2. Vendosja e 3(tre) ormaneve elektrik me dimensione 80x35xx120cm dhe 1(një)orman kablllovik me dimensione 80x35x120 cm, në rrugën “Sejdi Begu” prapa ish “Shtëpisë së Madhrave“ nëlokacionin e paraqitur sipas paraqitjes grafike në situacion të projektit ideor;
3. Vendosja e 3 (tre) ormaneve me dimensione 80x35x120cm dhe 1(një)orman kablllovik me dimensione 80x35x120 cm,në rrugën “Pushkatarët”gjgjësisht në trotuar të hyrjes së ish Qylhanit apo ish “Qendrës së Zejeve”, në lokacionin e paraqitur sipas paraqitjes grafike në situacion të projektit ideor;
4. Vendosja e 3 (tre) ormaneve me dimensione 80x35x120 cm dhe 1(një) orman kablllovik me dimensione 80x35x120 cm,në hapsirën e brendshme të trafos elektrike,e cila gjindet në rrugën “Ismet jashar Kumanova” në lokacionin e paraqitur sipas paraqitjes grafike në situacion të projektit ideor;

5. Vendosija e 5 (pesë) ormaneve me dimensione 80x35x120cm dhe 1 (një) orman kabllovik me dimensione 80x35x120cm, në perimetër të murit rrethues të Kishës së Shën Spasit –Shëlbëluesit (Nr.unik 02855), në lokacionin e paraqitur sipas paraqitjes grafike në situacion të projektit ideor;

III. Dokumentacioni teknik -Projekti Kryesor i punuar nga byroja projektuese “Instituti I Shkencës dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K.

IV Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh dhe obligohet që të njoftojë QRTK-Prizren 7 ditë para fillimit të punimeve.

IV. Hunjëzimi të bëhet simpas dokumentacioni teknik..

Investitori është i obliguar që punimet të kryhen në bazë të dokumentacionit teknik-projektit e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullat të përkohshme teknike për kësi llojë punime .

V. Investitori duhet të përmbahet pëlqimeve:

- Vendim I QRTK-së me nr.217-2 të dt.25.06.2024 dhe Vendimit të QRTK-së (plotësim-ndryshim) me nr.217-4 të dt.26.09.2024
- Rekomandimi I KTKQHP të dt. 10.07.2024.
- Pëlqim I Kishës Ortodokse Sërbe

VI. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendpunishten menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme.

VII. Pas përfundimit të punimeve Investitori duhet të parashtrojë kërkesën për pranimin teknik dhe marrjen e lejes për shfrytëzim.

## A r s y e t i m

**Drejtoria e Shërbimeve Publike -DSHP** me seli në Prizren është drejtuar këtij organi **me kërkesë** për realizimin e projektit : - Vendosija e ormanëve elektrike dhe të kabllovikut në “Sheshin Shadërvan ” në zonën e pare të mbrojtur .

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv


**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës MMPHI-së – Prishtinë.

Bashkëpunëtor profesional:



Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.

Drejtori:



Pranverim Berisha, jur